

**LULJETA MINE
ARJAN SHUMELI**

**LLAZAR TRESKA: NJË NGA THEMELUESIT E
TERMINOLOGJISË SË PYLLTARISË**

1. Hyrje

Llazar Treska lindi në 15 shtator 1909 në fshatin Treskë, Korçë. Kreu Liceun Francez të Korçës, më pas Shkollën Kombëtare të Ujrave dhe Pyjeve në Nansi (Francë 1932); Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve pranë Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare (1932 -1944). Nga viti 1944 -1946 Kryetar i Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar, organ i dalë nga lufta për administrimin e qyteteve të sapo çliruara deri në ngritjen e organeve lokale. Kryebashkiak i Tiranës nga viti 1947-1949. Rikthehet si specialist pyjesh me disa detyra dhe më pas themelues dhe Dekan i Fakultetit të Shkencave Pyjore prej vitit 1959 deri në 1980.

Profesor Treska me kontributin e tij i dha gjithçka terminologjisë së pylltarisë. Ai hodhi bazat e silvikulturës si edhe është themeluesi i arsimit të lartë pyjor në Shqipëri. Përgatitja e tij profesionale si dhe zotërimi i disa gjuhëve të huaja bënë që ai të linte gjurmë në terminologjinë e pylltarisë.

Treska ishte një nga pionierët e parë i cili hodhi rrënjët e pylltarisë shqiptare. Ai hapi kursin e parë për pylltarinë, hodhi hapat e para për arsimin profesional pyjor në Shqipëri si dhe bazat teorike të fushës së pylltarisë shqiptare. Botimet e Ll. Treskës, padyshim, mbushën një zbrazësi në terminologjinë e pylltarisë të viteve 60-80.

Synimi kryesor në këtë punimi është që të paraqesim kontributin e Prof. Treskës në terminologjinë e pylltarisë si dhe pasurinë leksikore terminologjike që trashëgojmë nga ai.

2. Llazar Treskës – themelues i terminologjisë së Silvikulturës (pylltarisë)

Për të zbuluar kontributin e tij në terminologjinë e pylltarisë, ne jemi bazuar dhe kemi studiuar disa vepra të tij si: Dendrometria, Silvikultura (I

dhe II), Manuali pyjor, etj. Këto botime bashkërendojnë njëkohësisht njohuritë për silvikulturën si dhe terminologjinë përkatëse për këtë nënfushë të pylltarisë. Këto vepra janë tregues jo vetëm i punës dhe kontributit mbresëlënës të Prof. Treskës, por edhe i lëndës së çmueshme leksikore terminologjike e cila shërbeu si bazë për botimet e mëvonshme në terminologjinë e pylltarisë, gjë që tregon se prurjet e tij terminologjike i kanë qëndruar kohës.

Në lëndën leksikore të këtyre veprave vërejmë terma me nga një ose më shumë elemente, por duhet theksuar se vendin kryesor e zënë njësitë (termat) që kanë në përbërjen e tyre dy ose më shumë elemente si *sipërfaqe pyjore, silvikulturë e zbatuar (vjen nga latinishtja silvi – pyll dhe culture – me kultivu), bimësi pyjore, shpërlarje sipërfaqësore, regjimi i rrjedhjes së ujrave, pëllgjet ujëmbledhës, panjë fletërrapi, druri i kininës, bimë mjekësore, bimë eterovajore, prerje gjethi, breza pyjore, masive pyjore, bimë njëqelizore, drurë të vetmuar, ritëm vegjetativ, drurë të vetmuar, krasitje natyrore, katet e bimësisë së pyllit, grumbuj pyjor me profil të pandërprerë, thellësia, trashësia e mbulesës së grumbullit pyjor, sistem biologjik i hapur, etj.*

Prurjet terminologjike të Treskës kanë burimet të ndryshme.

Së pari, duke nisur nga fjala e zakonshme e leksikut të përgjithshëm, disa fjalë marrin kuptim special, marrin statusin e termit, pra terminilizohen si edhe hyjnë në terminologjinë e pylltarisë. Si rezultat, fjala e gjuhës së përgjithshme, në një nga kuptimet e veta është specializuar për emërtimin e një nocioni të ri, shkencor, i jepet një kuptim i ngushtë terminologjik si *majë (e drurit), fletë (e gjethes), bosht (i trungut), kat (i pyllit), brez (toke), grumbull (pyjor), shpërlarje (sipërfaqësore), kurorë (e drurit, e grumbullit pyjor)* etj.

Këto terma të sipërshënuar gjejnë përdorim dhe veçohen si të tillë gjatë përdorimit në fushën e pylltarisë. Mund të thuhet se ato përbëjnë një shtresim leksikor në këtë fushë. Kjo gjë vërehet në të gjitha botimet e prof. Treskës.

Bazuar në strukturën dhe elementët përbërës të termave të përdorur nga Treska, vërejmë se ato mund të jenë fjalë të thjeshta (d.m.th. me strukturë të thjeshtë) të tilla si *grumbull, lëgushë, gutaperka, dru, pyll, panjë, kurorë, degë, gjethë*, etj., dhe togfjalësha (me strukture të përbërë) duke arritur deri në një shprehje terminologjike, si, p.sh.:

grumbull



grumbull pyjor




grumbull pyjor me profil të pandërprerë

Nisur nga paraqitja grafike, mund të thuhet se termat janë të lidhura nga një term kyç, në këtë rast me termin “grumbull” i cili përmban dhe ngarkesën kryesore konceptore. Ky term është bazë e formimit të togfjalëshave të tjerë si *grumbull pyjor*, *grumbull i virgjër*; *grumbull natyror*, *grumbull artificial*, *grumbull farorë*, *grumbull lastaror*, *grumbull me prejardhje të përzier*, *grumbull i thjeshtë*, *grumbull i përbërë*, *grumbull i rregullt*, *grumbull i çrregullt*, *grumbull njëmoshor*, *grumbull shumëmoshor*, *grumbull i ri*, *grumbull i pjekur*, *grumbull i vjetër*, *grumbull njëkatësh*, *grumbull me profil të pandërprerë*, *grumbull me profil të valëzuar*, *grumbull me profil të dhëmbëzuar*, etj.

Nga lënda leksikore e vjelë, në veprat e tij mund të vërehen dhjetëra mikrosisteme leksikore tematike të tilla si mikrosisteme të krijuara me termat “*dru*”, “*bimë*”, “*tokë*”, “*specie*” etj, si p.sh. *dru mbizotërues*, *dru zotërues*, *dru bashkëzotërues*, *dru i zotëruar (i nënshtruar)*, *dru i vdekur (i thatë)*; *bimë treguese*, *bimë indiferente*, *bimë preferuese*, *bimë mjekësore*, *bimë eterovajore*, *toka të lagëta*, *toka gëlqerore*, *toka të thata*, *toka të shkriфта*, *toka të ftohta*, *toka të nxehta*, *toka të ngjeshura*, *toka të pjerrësuara*, *toka shistoze*, *toka argjiloranore*, *specie kryesore*, *specie bazë*, *specie të dyta*, *specie ndihmëse*, *specie nxitëse*, *specie me përzierje të rregullt*, *specie me përzierje të parregullt*, *specie me përzierje intime*, *specie me përzierje në tufa*, *specie me togje të vegjël*, *specie me togje të mëdha*, *specie me përzierje të përkohshme*, *specie me përzierje të përhershme*, etj.

Për të sjellë një tablo më të qartë, po sjellim grafikisht një mikrosistem të krijuar nga termi *dru*.



Siç shihet, termat e mësipërm togfjalësh, si shprehje më e theksuar e lidhjeve sistimore në rrafshin e formës sillen rreth një njësie (në rastin tonë *dru*), që shënon konceptin kryesor, ku bashkohen një varg termash të tjerë. Termi kryesor trajtohet si term kyç i cili krijon lidhje me njësitë e tjera.

Duhet nënvizuar fakti se këto terma të sjella nga Treska janë një pjesë mjaft e rëndësishme e terminologjisë pyjore për nga përdorimi i tyre, vendi që zënë në tekste, manuale, artikuj, etj.

Krahas kësaj, terminologjia e tij spikat nga përdorimi i togfjalëshave të qëndrueshëm të cilët tregojnë një hop cilësor të zhvillimit të kësaj terminologjie në atë kohë.

Përdorimi i togfjalëshave terminologjik i jep terminologjisë një karakter sistemor, të lidhur, hierarkik, por edhe krijon saktësi e qartësi të dukshme në zbulimin e përmbajtjes së termit, pra të konceptit.

Nga ana e ndërtimit gramatikor, togfjalëshat terminologjik të përdorur nga Treska formojnë modele kryesisht me bazë emërore si:

emër+emër

katet e pyllit, ritëm vegjetativ, grumbull drurësh, faktor i kubimit, trashësia e mbulesës së pyllit, dendësi e pyllit, matje e drurit,

formë e drurit, zhvillim i drurit, fiziologji e drurit, depozitimi i qelizave, pjerrësi e terrenit, kurorë e drurit, etj.

emër +mbiemër

grumbull pyjor, grumbull i virgjër; grumbull natyror, grumbull artificial, grumbull farorë, grumbull lastaror, grumbull i thjeshtë, grumbull i përbërë, grumbull i rregullt, grumbull i çrregullt, etj.

emër+parafjale+emër+mbiemër

specie me togje të mëdha, specie me përzierje të përkohshme, specie me përzierje të përhershme, grumbull me profil të pandërprerë, grumbull me profil të valëzuar, grumbull me profil të dhëmbëzuar, etj.

Së dyti, një burim tjetër me interes përbëjnë fushat e tjera të dijes me të cilat lidhet terminologjia në fjalë, të tilla si:

Terma nga kimia: *azot, dioksid i karbonit, fosfor, oksigjen, calcium.*

Terma nga biologjia: *fotosintezë, mikroorganizma, patogjene, bimë njëqelizore,, asimilimi klorofilian.*

Terma nga mjekësia: *rruazat e kuqe, gjendra me sekretim,të brendshëm, rakitizmi, tuberkulozi, sëmundje infektive, sëmundje endemike, malarje, mikrobe.*

Terma nga fizika: *presion atmosferik.*

Terma nga bujqësia: *kultura bujqësore, toka podzolike, fitocenoza.*

Terma nga matematika: *ekuacion, kurbë, koeficient, përqindje.*

Terma nga gjeometria: *rrathë, dimensione, formë konike; plan horizontal, lartësi, gjatësi e trungut, volum, lartësi, diametër, kubimim, sipërfaqe rrethore.*

Së treti, lënda leksikore e përdorur nga Treska është e përzgjedhur dhe e larmishme. Duke qenë një njohës i mirë i disa gjuhëve të huaja, kjo gjë ka lënë gjurmë dhe, sigurisht përbën një nga burimet e lëndës leksikore në tekstet universitare të hartuara prej tij. Lidhur me këtë çështje, Prof. Jani Thomai mendon se “huazimi leksikor, ndryshe nga leksiku dialektor e krahinor dhe neologjia shumë herë mbetet një burim i detyrueshëm, veçanërisht për fjalë ndërkombëtare dhe për terma të disa fushave tekniko-shkencore ose me zhvillim të ri te ne sot” Kjo gjen pasqyrim në përdorimin e disa huazimeve të cilat shfaqen në leksikun terminologjik të Treskës si: *silvikulturë, medikamente, konsistencë, indirekte, latekset, asimilim, specie, asociacion bimor, ligjet e suksesionit, etj.*

Ndoshta, për kohën kur ato u përdorën, ishin të domosdoshme për plotësimin e nevojave të terminologjisë së pylltarisë, sepse tashmë dihet se huazimi është një nga rrugët për pasurimin në mënyrë të shpejtë të një

gjuhe. Gjithsesi, huazimet e pakta nuk e zbehin kontributin e tij në fushën e pylltarisë.

Së katërti, është e rëndësishme të pohojmë se Prof. Treska i shfrytëzon më së miri mënyrat e fjalëformimit të shqipes, si p.sh *rrugën morfologjike*. Si veçori të kësaj rruge mund të përmendim aktivizimin e një sasive të caktuar të parashtesave dhe prapashtesave. Disa prej tyre janë tregues i autoktonësisë së gjuhës shqipe, si p.sh. disa mjete të lashta fjalëformuese të tillë si prapashtesat *-ishte*, -është “ që një varg dijetarësh i kanë lidhur me *-e(i)sta*, *-(e)ste* të ilirishtes”. Për rrjedhojë kemi *plepishhtë*, *ahishtë*, *cungishte*, *trungishte*, etj.

Nga shqyrtimi që u është bërë termave të përfshira në veprat e lartpërmendura, vërehen këto raste si me:

a) Prapashtesim

-ishte: *shelgjishte*, *vërrishte*, *plepishte*, *bredhishte*, *ahishte*, *trungishte*, *barishte*.

-ajë: *imshtajë*, *gëmushajë*; *dushkajë*.

-ore; *drunore*, *barishtore*.

b) Parashtesim

vetë: *vetërregulluese*, *vetëripërtëritje*, *vetëkrasitje*.

bio-: *biogjenezë*, *biosferë*, *biosisteme*, *biogjeocenoza*, *bioekologjike*, *biokimike*, *biocenozë*, *biomasë*.

mbi-: *mbizotëruese*

nën-: *nëndrunishte*, *nënpyll*, *nëngrumbull*, *nënklasë*, *nënzonë*.

pa- *e papërdorshme*

a- *asimetrike*

fito - : *fitoklimë*, *fitocenozë*.

silvo - : *silvobiologji*, *silvoteknikë*.

c) Kompozita: *kurorëdendësi*, *jetëgjatësi*; *hijedashëse*, *dritëdashëse*, *bashkëzotërues*, *vetëkrasitje*, *(panjë) fletërrapi*, etj.

Një fenomen gjuhësor që shfaqet në këto vepra është sinonimia. Sinonimet këtu na shfaqen si fjalë që përputhen nga ana kuptimore, por shfaqen me veshje të ndryshme tingullore. Sigurisht, që sinoniminë në lëndën terminologjike të Treskës e shohim në kontekstin e sinonimeve dublete. p.sh. *krasitje natyrore* – *vetëkrasitje*, *silvoteknikë* – *silvikulturë e zbatuar*, etj.

Më poshtë po japim një tablo të sinonimive sipas pjesëve të ligjëratës dhe përbërjes strukturore të tyre.

Terma emra ose terma me bazë emërore

a) fjalë – fjalë:

nëndrunishtja – nënpylli/nëngrumbulli, latekse – kauçuku, zbrazëtirë – çeltirë, kurorëdendësi – konsistencë, ekspozicion – kundrejt, regresion – zmbbrasje, etj.

b) fjalë – togfjalësh:

dendrometri - matje druri, drunishtja- grumbull pyjor/kat i drurëve, silvoteknikë – silvikulturë e zbatuar, altituda – lartësia nga deti, vetëkrasitje - krasitje natyrore, etj.

Terma mbiemra

a) fjalë shqip - fjalë shqip:

(pyll) shumëmoshor – (pyll) i përzier, (grumbull) njëmoshor – (grumbull) i rregullt, (drurë) të zotëruar - të nënshtruar, etj

b) fjalë e huaj – fjalë shqip

monokat - njëkatësh, etj.

Shumë shpesh thuhet se sinonimia është e padëshirueshme në terminologji, por jo e pashmangshme. Ky fenomen shfaqet aq rrallë në pasurinë leksikore të trashëguar nga Prof. Treska sa nuk na jep shkas që të mendojmë, se ka dëmtuar vlerat e mëdha që mbartin veprat e tij.

Përveç emrave, mbiemrave ai ka përfshirë dhe përdorur folje si *ozonifikojnë, gjethtëzojnë, frutifikojnë, bleron*, etj, të cilat nuk i has në tekstet e tjera universitare të asaj kohe.

Interesant është fakti se Treska e shikon pyllin në disa aspekte, jo thjesht për prodhimin e lëndës drusore, por edhe në lidhje me shëndetin, në funksion të urbanistikës, gjuetisë, etj, gjë që e bën të veçantë kontributin e tij në fushën e pylltarisë. Ai ka krijuar një skedë të re termash për bimësinë pyjore. Është njohës i mirë i specieve (llojeve) ekzistuese në Shqipëri duke i përfshirë ato sipas kateve të pyllit dhe vendndodhjes së tyre në krahina të ndryshme të vendit tonë, si *panjë fletërrapi, hormoq, vërriu, shelgu, zogla, mëshiteknë, druri i kikinës, bliri, ah-u, boronicë, dëllënbjë, pishë, bredh-i, lajthi, thanë, shqopë, mersinë, gjineshtër, ferrë, larshi, robinia*, etj.

Krahas llojeve të ndryshme të drurëve, shkurreve, Prof. Treska i ka kushtuar një hapësirë të madhe, edhe emërtimeve të popullatave të kafshëve dhe insekteve p.sh. *lepur i egër, lepur i butë, derr i egër, krimb i mëndafshit, thëllëza, pëllumb, rosë, kaproll, rriqebull, ari-u, gjell i egër, bletë*, etj.

Materiali gjuhësor terminologjik i Prof. Treskës ka zënë një vend shumë të rëndësishëm në terminologjinë e pylltarisë. Ai tashmë njihet si krijuesi i silvikulturës shqiptare. Është e rëndësishme të pohojmë se, ai ka

bëre jo vetëm një punë të vlerësueshme shkencore, por edhe terminologjike. Veprat e tij përbëjnë fjalësin kryesor të silvikulturës së sotshme.

Përfundime

Pjesa dërmuese e materialit gjuhësor vjen nga gjuha shqipe. Ajo ze vendin kryesor në terminologjinë e përdorur nga Treska. Kjo është dëshmi e një pasurie të madhe gjuhësore në tërësinë e terminologjisë shqipe të pylltarisë.

Mbështetur në lëndën leksikore të përdorur nga Treska vërejmë se kjo lëndë përbën gurin themeltar të terminologjisë së silvikulturës (pylltarisë).

Ndërsa, mbështetur në vlerën leksiko – gramatikore të elementeve gjuhësore të termave togfjalësh të përdorur, mund të thuhet se ajo është e larmishme dhe e rëndësishme për terminologjinë e pylltarisë.

Ai sjell një material gjuhësor të spikatur për silvikulturën. Kjo lëndë e çmueshme shpreh punën e tij këmbëngulëse ndër vite. Ajo ka zënë vend edhe sot në terminologjinë e pylltarisë. Interesant është fakti se ai ka bërë një punë shkencore lidhur me futjen e termave të rinj që i përkasin fushës së pylltarisë si *prerje gjethi, panjë fletërrapi, drurë të vetmuar, shpërlarje sipërfaqësore, ozonifikojnë*, etj.

Si përfundim, Prof. Treska është njohës i mirë i shqipes, e përdor mirë atë, në funksion të terminologjisë pyjore. Ai ka lehtësuar punën e qindra inxhinierëve të pyjeve si edhe ka dhënë një ndihmesë të vyer autorëve të mëvonshëm në hartimin e teksteve, manualeve, artikujve për fushën e pylltarisë. Terminologjia e Treskës përbën një pasuri terminologjike kombëtare për fushën e pylltarisë.

BIBLIOGRAFI

- Mine, L., Disertacion “Leksiku terminologjik i pylltarisë në përqsja me gjuhën angleze”, Tiranë 2013.
- Pepa, Simon. “Studime Filologjike”, nr. 3, 1983.
- Treska, Ll., (1959) “Manuali Pyjor”.
- Treska, Ll., Xheko, B. (1982) “Silvikultura I”.
- Treska, Ll., Xheko, B. (1982) “Silvikultura II”.
- Thomai, J., “Shqipja standarde dhe leksikografia shqiptare”, konf. shkenc, Tiranë, 2003.
- Treska, Ll., Lako, Th. (1985), “Dendrometria”.